

VENOMI SHTË I PLOTFUQISHËM  
DILJUKA JE PRAVNO-SNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SHTË  
FERIZAJ / UROŠEVAC.

NE EMER TE POPULLIT

Më  
Dana

13.06.2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I  
PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, në  
përbërje me gjyqtaren, Hysnije Gashi, si dhe me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në  
çështjen penale kundër të pandehurve: [REDACTED] për shkak të veprës  
penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par 1 nën par 4 lidhur me nenin të KPK-, sipas  
aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP.nr.1408-5/2012 të dtës 25 shtator  
2012, në pranin e përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të  
pandehurit : [REDACTED] dhe mbrojtësit me autorizim av. [REDACTED]

[REDACTED] përfaqësuesja ligjore të dëmtuarit - ndjerit [REDACTED], përfaqësuesi i  
autorizuar i palës së dëmtuar, Av. [REDACTED], pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më  
dt.16.01.2018, morri publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1. [REDACTED] nga fshati [REDACTED] K.Ferizaj i lindur me [REDACTED] në të njtin vend,  
nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] ka kryer shkollën e mesme , me  
profesion polic, i martuar babë i katër fëmijëve e gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar  
shtetas i Republikës së Kosovës .

2. [REDACTED] nga fshati [REDACTED], komuna Ferizaj, i lindur më 20.11.1956 në të  
njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] , e gjinisë [REDACTED] i martuar , tregtar, i  
gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

## JANE FAJTOR

Sepse: me datë 13.08.2012, rrëth orës 18:30, në fshatin Zaskok, i kanë shkaktuar lëndim të rëndë trupor të dëmtuarit [REDAKTUE] i cili ishte në pronën e tij bashk me vëllezërit [REDAKTUE] e [REDAKTUE], në at mënyrë që pas një mosmarrëveshje lidhur me një kontest pronësor, fillon konflikti verbal dhe përleshja fizike mes vëllait të të pandehurve [REDAKTUE] me të dëmtuarin [REDAKTUE] në ndërkokë arrijnë të pandehurit [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] të cilët fillojnë ta godasin disa herë

-me këtë ka kryer veprën penale bashkëkryerje lëndim i rëndë trupor nga nen 154 par 1 nën par 4 lidhur me nenin të KPK-, së

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të përmendura dhe nen 3, 6, 11, 41, 42, 43, 44 ,64, të KPK-së si dhe nenin 365 të KPPK-së të pandehurit :

## GJ Y K O N

### DËNIM ME KUSHT

Denim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy ) viteve , i cili denim nuk do të ekzekutohet nëse te pandehurit në periudhën kohore prej 2 (dy ) viteve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykim i nuk kryen vepër tjetër penale.

Perfaqsuesi ligjor i të ndjerit [REDAKTUE], bashkëshortja e tij [REDAKTUE] për realizimin e kërkeshës pasurore - juridike udhëzohet në kontest civil.

Të pandehurit, obligohet që secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumen prej 30 (tridhjet) Euro, shpenzimet procedurës penale 40.88.euro dhe supet ekspertiza 150 euro .

Detyrohen të akuzuarit që për kompensimin e Vikiuave të Krimtit obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

### Arsyimi

#### Historiku i procedurës

Prokuroria Komunale në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr.1408-05/2012 të datës 25.shtator 2012 , kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED] për veprën penale bashkëkryerje lëndim i rëndë trupor nga neni 154,par 1 nën par 4 lidhur me nenin 23,të të KPK-së,

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale, mbajti shqyrtimin gjyqësor me datën 24.02.2014 ku nuk janë plotësuar kushtet përmajtjen e shqyrtimit gjyqësor me dtën . me datën 04.10.2016

Para fillimit të shqyrtimit gjyqësor me aktvendim të veçante P.nr.1607/12 te dt.04.10.2016 ka hudhë aktakuzën per te pandehurit : [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED]  
[REDACTED] dhe [REDACTED] per shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153.par 1 nën par 4 lidhur me nen.23 te KPK-së për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale dhe ka vazhduar shqyrtimin gjyqësorë përmajtjen e shqyrtimit gjyqësor me dtën [REDACTED] dhe [REDACTED]  
[REDACTED] per veprën penale ne bashkëkryerje lëndim e rëndë trupor nga neni 154 par 1 nën par 4 lidhur ne nen.23 të KPK-së.

#### I. Mbrotja e të akuzuarve

I akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka mohuar veprën penale e cila e vihet në barrë, duke deklaruar se ditën kritike ka qenë duke shpërnda ftesa per martesën e vajzës së tij deri ka ora 17: 00 dhe pasi qe kishte shkuar në shtëpi nëna e tij [REDACTED] ishte sëmurë dhe të njëjtën e kishte dërguar në QMF në Ferizaj rrëth orës 18:00 dhe pastaj në shtëpi ishte kthyer aty rrëth orës 19:30 dhe duke u

kthyer kishte shkuar te vëllu i tij [REDACTED] aty ishte takuar me babain i tij [REDACTED] dhe vëllain [REDACTED] dhe në ato momente kishte kuptuar se vëllezërit t' tij ishin fjalosur me fqinjët e tyre, [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe arsyja e konfliktit në mes dy familjeve ka qenë një pronë e një serbi e kufizuar me pronën e vëllaut të tij [REDACTED].

I Akuzuari [REDACTED] në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në shtëpi me bashkëshorten e tij dhe gjersa ishte ne ahurin e bagëtive kishte dëgjuar një automjet të policisë tek shtëpia e [REDACTED] vëllait të tij dhe aty kishte kuptuar se ka ndodhe një mosmarrëveshje në mes të vëllezërve të tij dhe familjes [REDACTED] dhe pastaj policia i kishte shoqëruar në stacion policor [REDACTED] [REDACTED] dhë [REDACTED], ka deklaruar se nuk ka qene në vendin e ngjarjes kur ka ndodhe mosmarrëveshja dhe rrahja në mes te dy familjeve.

#### Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë per veprën penale sipas kësaj aktakuze , Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një, duke i lidhur reciprokisht njëren me tjetren , vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar hollësishët në dipozitivin e këtij Aktgjykimi.

Gjykata, gjendjen faktike e ka vërtetuar përmes provave te prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet te akuzuarve
- nga leximi i deklaratës së te ndjerit të dëmtuarit – dëshmitarit Gezim Hamiti, dëshmitareve : [REDACTED] dhe [REDACTED], dr. [REDACTED]
- mendimi dhe konstatimi mjeko-ligjor i datës 16.09.2012
- shiqimi në librin e evidencave të vizitave mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare ne 4 në Ferizaj
- Super ekspertiza mjekësore e datës 11.10.2016
- fotografat të cilat gjinden ne shkresat e lëndës

#### Vlerësimi i provave te paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor

Meqë i dëmtuari –dëshmitari [REDACTED] sipas familjareve dhe certifikatës së vdekjes V00140740 te dtës 26.08.2013 ka vdekë me dtën 30.01.2013 Gjykata konform

nenit 338 par 1 dhe 1.1 dhe me pëlqimin e palëve në procedurë lexoi deklaratën e të ndjerit dëshmitarit - te dëmtarit, [REDACTED] nga deponimi i dëmtuarit të dhënë me datën 30.gusht 2012 në Prokurorinë Komunale në Ferizaj është vërtetuar se ditën kritik i dëmtuarit së bashku me vëllezërit e tij [REDACTED] dhe [REDACTED] kishin shkuar se bashku me fëmijët në pronën e tyre e cila gjendej një kilometër nga shtëpia e tij dhe në ato momente kishte dal [REDACTED] me djalin e tij [REDACTED] dhe kishin filluar te bisedonin me vëllain e tij [REDACTED] ku i njëjtë ishte në largësi nga ta afërsisht 20 metra, dhe kishte dëgjuar se [REDACTED] i kishte thëne vëllut të tij "çka po doni kush jeni ju, çka jeni duke lyp" këtu pastaj i dëmtuar ishte afruar dhe i kishte pyetur [REDACTED] se çka po ndodhë dhe pastaj kishin ardhur katër automjete njëra Mercedes dhe nga ata persona dhe në mesin e tyre kishte njobur [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED] ndërsa personat e tjerë nuk i kishte njobur, pastaj ishte afruar [REDACTED] dhe i kishte thëne se" kam me ju kajtë nënën "dhe aty se pari [REDACTED] e kishte goditur të dëmtuarin [REDACTED] një here me grusht në barkë dhe posa e kishte kthyer kokën [REDACTED] e kishte goditur në anën e majtë të fytyrës pastaj kishte ndërhy [REDACTED] i cili e kishte goditur me grusht në fytyre, kryesisht në gojë dhe pastaj i dëmtuarit ishte rrënxitur në tokë dhe pastaj të gjithë e kishin goditur me shkelma përvçe [REDACTED], me tej deklaron se goditjet në fytyre i kishte marre nga [REDACTED] dhe [REDACTED] te cilët e njihet mire.

I dëmtuarit iu ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka parashtruar kërkeshën pasurore juridike.

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] e dhëne në prokurori me datën 17.gusht 2012 konstatohet se i njëjtë ditën kritike me vëllezërit e tij [REDACTED], [REDACTED] dhe fëmijët e tyre kanë dalë ne pronën e tyre dhe atu kanë takuar [REDACTED] me djalin e tij [REDACTED] i cili iu kishte drejtuar më fjalët se çka po kërkonin në pronën e tyre ku [REDACTED] iu kishte thëne se ne jemi në tokën tonë pastaj kishte ardhur [REDACTED] dhe ishte përshëndetur dhe në ato momente kishin ardhur 4 vetura dhe nga to kishin zbrit [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED], [REDACTED] dhe fillimisht [REDACTED] i kishte sharë [REDACTED] dhe [REDACTED] pastaj [REDACTED] dhe [REDACTED] e kishin goditur [REDACTED] nënofull njeri në anën e majte e tjetri në anën e djathtë ndërsa [REDACTED] e kishte goditur në kokë dhe ne ato momete [REDACTED] ishte rrezuar në tokë dhe pastaj me shkelma e kishin goditur [REDACTED], [REDACTED] [REDACTED], [REDACTED] pastaj dëshmitari pasi qe i kishte larguar fëmijët nga

vendi i ngjarjes ishte afruar per ti ndihmuar vellezerve te tij dhe ne kacafytje me [REDACTED]  
[REDACTED] dikush nga prapa e kishte goditur ne qafe ku kishte marre lendime trupore.

Nga deshmia deshmitarit, [REDACTED] konstatohet se diten kritike deshmitari se bashku me vellezerit e tij [REDACTED], [REDACTED] dhe femijet e tyre kishin dalur ne pronen e e tyre dhe aty kishin takuar [REDACTED] dhe djalin e tij [REDACTED] dhe [REDACTED] i kishte thene qe te largohen nga aty se dot ua bejmeh varrin aty ndersa [REDACTED] iu kishte përgjigjur se varrin bene per vete se na do te ndertojmë shtepi ketu dhe pas pesë minutave kishin archur katër automjete nga kanë zbritur [REDACTED], [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] dhe disa te ri te moshës 20-25 vjeçare dhe fillisht [REDACTED] i kishte fyer ndersa [REDACTED] e kishte goditur ne bark [REDACTED] pastaj [REDACTED] e kishte goditur me grusht ne nofull po ashtu edhe [REDACTED] e kishte goditur nga prapa ku nga kjo goditje [REDACTED] kishte renë ne tokë Pastaj [REDACTED] e kishte kapur deshmitarin per flokë pastaj [REDACTED] e kishte goditur ne hundë ku nga kjo goditje e kishte pasur hundën e thyer dhe nga prapa e kishin goditur [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED]

Nga deshmia e deshmitares, [REDACTED] konstatohet se njëjtë eshtë infermieri ne Qendren numër një te Mjeksisë familjare ne Ferizaj dhe i kujtohet se diten kritike ka qene pacientja me mbiemrin [REDACTED] dhe sipas udhëzimeve te dr [REDACTED] te njesit ia ka dhënë një injekcion dhe koha kur pacientja eshtë trajtuar ne këtë qendër ka qene aty rreth orës 20 h ne përfundim të orarit të punës ,

Nga deshmia e deshmitarit dr, [REDACTED] konstatohet se dita kritike kur ishte duke e zevendesuar një kolegë të tij ne Qendrën e mjekesisë familjare kishte shkuar polici [REDACTED] me nënën e tij te cilës i ka përshkruar një injekcion por nuk i kujtohet ora e saktë kur ka kerkuar ndihme pacientja por përafersisht diku pas orës 17:00.

#### Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Deshmisë se të dëmtuarit tanë të ndjerit [REDACTED] dhe deshmitarëve [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED], gjykata u shprehi besimin e plotë të cilat i vlereson si bindëse dhe reale, ngase ne mënyrë të qartë dhe konkrete kanë përshkruar ngjarjen se , diten kritike pasi që i dëmtuari tanë i ndjeri [REDACTED] dhe vellezërit e ti [REDACTED] dhe [REDACTED] pas një mosmarrëveshje lidhur me një kontest pronësor,

kishte filluar konflikti verbal dhe përleshja fizike ne mes vëllait të të pandehurve [REDACTED] me të dëmtuarin [REDACTED], në ndërkokë arrijnë në pandehurit [REDACTED] dhë [REDACTED] të cilët fillojnë ta godasin disa herë me grushtë të dëmtuarin [REDACTED] në nofullën e djathtë dhe të majtë, ku nga këto goditje i dëmtuari merr lëndime te rënda trupore

Te gjitha këto dëshmi Gjykata i ndërlidhi me Ekspertizën Mjeko-Ligjore te datës 16.09.2012 dëmtime e përshkruara në diagnozën mjekësore për te dëmtuarin [REDACTED] paraqesin: Thyerje e kockës nofullës(degës së maltë),çarje e trupit të kockës së nofullës së majtë, Thyerje me zhvendosje të fragmenteve të kockës së nofullës (degës) së djathtë, lëndimet janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbrojtës (jo te mpreht,lëndjme te tillë ,klasifikohen si Dëmtime te rënda trupore.

Po ashtu, përfaqësuesi ligor i të dëmtuarit të ndjerit [REDACTED] dhe përfaqësuesi me autorizim Av [REDACTED] kanë propozuar që te behet ekspertiza mjeko ligjore nga Instituti i Mjekësisë ligjore në Prishtine per te vërtetuar rrëthanat se a ekziston lidhja kauzale e lëndimeve te shkaktuara në këte përleshje me shkakun e vdekjes se te dëmtuarit-te ndjerit [REDACTED], të cilin propozim Gjykata e pranoi dhe lëndën e dërgoi në Institutin e Mjekësisë ligjore në Prishtinë dhe nga super ekspertiza e Institutit të mjekësisë Ligjore e datës 27.10.2016 rezulton se lëndimet trupore të pësuara në përleshjen në muajin Gusht, 2012, nuk kanë lidhje kauzale me Vdekjen e tanit te ndjerit.

Kurse nga shikimi me librin e evidencave te vizitave mjekësore në QMF nr 4 ne Ferizaj është konstatuar se [REDACTED] është e evidentuar në ketë regjistër me nr rendor 24 mirëpo në këte regjistër nuk shkruan data e as ora se kur pacientja ka kërkuar ndihmën mjekësore.

#### Vlersimi i mbrojtjes se te akuzuarve

Mbrojtja e të akuzuarit [REDACTED] gjatë procedurës hetimore ashtu edhe në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në mbrojtjen e tij se nuk e ka kryet veprën panele me te cilën ë ngarkon akuza duke theksuar se ditën kritike nuk kishte qenë në vendin e ngjarjes kur ka ndodhur mosmavesha pasi që e kishte dërguar nënën e ti tij në QMF në Ferizaj rrëth orës 18:00 dhe pas marrjes se terapinë ishte nisur për tu kthyer në

shtëpi aty rrëth orës 19:30 dhe duke u kthyer kishte shkuar te vëllu i ti [REDACTED], aty kishte takuar babain i tij [REDACTED] dhe vëllain [REDACTED] dhe në ato momente kishte kuptuar se diçka nuk ishte në rregull dhe kishte kuptuar se vëllezërit tij ishin fjalosur me fqinjët e tyre, [REDACTED] dhe [REDACTED] por megjithatë në mbrojtjen e tij i akuzuari nuk e ka mohuar faktin se ditën kritike ka takuar vëllezërit e qe sipas dëshmisë së dëmtuarit [REDACTED], dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] vetëtojnë faktin se i akuzuari [REDACTED] te cilin e identifikojnë si ([REDACTED] polici) dhe i akuzuari [REDACTED] ditën kritike e kanë qenë në vendin e ngjarjes dhc kanë goditur te dëmtuarin [REDACTED] me grushta nënofullën e djathte dhe te majtë ku nga ato goditje i njëjtë ka pësuar lëndime te renda trupore, po ashtu sa i përket alibisë te të njëjtët se kinse nuk ka qene në vendin e ka ndodhur konflikti pasi e ka dërguar tek mjeku nënën e tij [REDACTED] në qendrën e mjekësisë Familjare dhe koha e kur i akuzuari deklaron se ka qëndruar qendrën e mjekësisë familiare nuk përputhen me dëshminë të dëmtuarit dhe deshmitareve e dëshmitareve infermieres [REDACTED] e cila ka dekluar se pacientja te cilën e kishte shoqëruar i akuzuari [REDACTED] ne qendrën e mjekësisë familjare ka qenë pak para përfundimit te orarit të punës atu kah ora 19:50 e mosmarrëveshja –konflikti në mes dy familjeve ka ndodhur rrëth orës [REDACTED] e që sipas dëshmisë së dëshmitareve konflikti në mes dy familjeve sipas dëshmitarëve ka zgjatur ne shume shkurt.

Po ashtu mbrojtja e te akuzuarit [REDACTED] se në kohen e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur konflikti është e paqëndrueshme meqë nuk gjënë mbështetje në asnjë provë materiale apo formale, andaj një tezë e tillë e mbrojtjes së te akuzuarve është në tersi e pa bazuar dhe e orientuar drejt justifikimit të veprimeve inkriminuese të të akuzuarve.

#### Vlerësimi i tezës së mbrojtjes së të akuzuarit [REDACTED]

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit [REDACTED] Av [REDACTED] në fjalën përfundimtare, i cili ka pretenduar se nuk është provuar se in akuzuari [REDACTED] ka kryer këtë vepër penale dhc ka propozuar lirimin e tij nga akuza, duke cilësuar dëshmitë e dëshmitarëve të dëmtuarit si të pa sakta dhe të pa vërteta.

Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit [REDACTED] janë të pa qëndrueshme nga arsyetimi qe do të paraqitet si më poshtë se i dëmtuarët : [REDACTED], megjithëse ishte edhe i dëmtuar, [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED],

paraqiten dëshmi tërësish objektive dhe reale , për më tepër dëshmitë te tyre janë elaboruar hollësish edhe në pjesën e sipërme te këtij aktgjykimi

Nga gjendja e tërësishme e fakteve në këtë qeshje penale në mënyrë të pa dyshimt rezulton se të akuzuarit pas një mosmarrëveshje lidhur me një kontest pronësor në mes vllaut të të pandehurve [REDACTED] dhe të dëmtuarit [REDACTED] të padeturit [REDACTED]

[REDACTED] dhe [REDACTED] fillojnë ta godasin të dëmturin [REDACTED] disa here me grushta nënofullën e djathte dhe te majtë ku nga ato goditje i dëmtuari merr lëndime te rënda trupore

#### 7. Vlersimi ligjor i veprime të të pandehurve

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se ne veprimet e te akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] formësohen tiparet objektive dhe subjektive te veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 154 par 1 nën par 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

#### 8. Vlersimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes se llojit dhe lartësisë se dënimit Gjykata vlerësoi rrethanat ne kuptim te nenit 64 KPK-se si rrethane lehtësuese për te akuzuarin [REDACTED] ka gjetur se i njëjtë nuk është i dënuar me aktgjykim te formës së prre , rrethanat familjare është baba i katër fëmijëve , nga koha e kryerjes se veprës penale ka kaluar ni periudhe relativisht e gjate

Si rrethane lehtësuese për te akuzuarin [REDACTED] ka gjetur se i njëjtë nuk është i dënuar me aktgjykim te formës së prre , rrethanat familjare është baba i pesë fëmijëve , nga koha e kryerjes se veprës penale ka kaluar një periudhe relativisht e gjate , ndërsa si rrethana rëndues, pesha dhe rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre penale që në rastin konkret ekziston peshë e rëndë dhe rrezikshmëri e lartë shoqërore kësaj vepre penale mbi bazën e vlerësimit të gjitha këtyre rrethanave gjykata të akuzuarve i shqiptoi dënim si në diapositiv duke qenë e bindur se një dënim të tillë është plotësish i justifikueshëm në raport me rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale , rrethanave të kryerjes, personalitetit të akuzuarve dhe me të do të arrihet qëllimi ndëshkimore nga neni 34 i KPPK-së në kuptim të preventivës individuale që tek akuzuara do të ndikojë në mënyrë edukative në parandalimin që në të ardhmen të mos kryejë vepra

penale si dhe në kuptim të preventivës gjenerale parandalimin e përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri .

#### 9. Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Përfaqsuesi i të ndjerit [REDACTED], për realizimin e kërkersës pasurore juridike udhëzohet në koston civil

Të akuzuarit secili veç e veç në emër të pashallit gjyqësor , obligohet që në emër të pashallit gjyqësor të paguajë shumen prej 30 (tridhjet) dhe shpenzimeve te procedurës penale 40.88 euro si dhe superekspretiza mjeko ligjore në shumë prej 150, euro Të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Detyrohen të akuzuarit që për kompensimin e Viktimate të Krimtit obligohet ta paguaj shumën prej 30€(tridhjetë/euro), brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**


P.nr.1607/12, dt.16.01.2018

Zyrtare ligjore

Albana Ujupi

Gjyqtari

Hysnije Gashi



#### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.